



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 29.11.2024

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.1) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës **27.11.2024** të parashtruar nga Operatorit ekonomik “Roza Komani B.I. , lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Riparimi dhe mirëmbajtja e QKMF-së 1, Orize, Dardani dhe Erenik “ , Nr. i prokurimit- 632-24-11698-5-2-1, Nr. i brendshëm 632-24-129-521, nxjerr:

V E N D I M

1. **Refuzohet** si e vonuar- jashtë afatit kërkesa për ri-shqyrtim e Operatorit ekonomik Roza Komani B.I...., e dt.27.11.2024.2024, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Riparimi dhe mirëmbajtja e QKMF-së 1, Orize, Dardani dhe Erenik “ , Nr. i prokurimit- 632-24-11698-5-2-1, Nr. i brendshëm 632-24-129-521, kundër DOSJES SË TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË, të datës 08.11.2024, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
2. **Vërtetohet DOSJA E TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË**, të publikuar me datë: **08.11.2024;**
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Operatori ekonomik Roza Komani B.I. me dt.27.11.2024, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim , lidhur me aktivitetin e prokurimit “Riparimi dhe mirëmbajtja e QKMF-së 1, Orize, Dardani dhe Erenik “ , Nr. i prokurimit- 632-24-11698-5-2-1, Nr. i brendshëm 632-24-129-521.

KOSOVA • REPUBLICA
KOMUNITI • KOSOVA

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, nuk ka bërë pezullimin e lëndës, sepse Operatori ekonomik ankues ka bërë Kërkesë për rishqyrtim pas afatit ligjor(neni 60 paragrafi 60.1 nën a, të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022).

Kërkesa për rishqyrtim, është dorëzuar me dt.27.11.2024, kurse dorëzimi I ofertave-hapja e tenderit do të bëhet me dt.29.11.2024, prandaj e njejta refuzohet si e vonuar, sepse nuk është dorëzuar brenda afatit kohor të përcaktuar në nenin 60.1 (a), të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022:

60.1 Kërkesa për rishqyrtim duhet të përmbajë të dhënat në pajtim me formularin F02 dhe duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik, funksioni “kërkesat për rishqyrtim” brenda afateve të mëposhtme:

a) Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit se paku pesë (5) ditë para afatit të fundit për dorëzimin të ofertave. Në kalkulim të afateve kohore dita e dorëzimit të ofertave është dita (0). Ky afat nuk aplikohet në rastet kur AK bën zgjatje të afatit të fundit për dorëzimin të ofertave pas vendimit për refuzim të kërkesës për rishqyrtim sipas Nenit 63.1.1 të kësaj rregullore.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thanë më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) diteve pas pranimi të këtij vendimi.

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

